

## Terma të rëndësishme në sistemin arsimor (Fjalori)

|                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|--------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Abitur                         | "Abitur" ju jep të drejtën të studioni në një universitet. Quhet gjithashtu "Hochschulreife", kualifikim i përgjithshëm i hyrjes në arsimin e lartë. (shikoni "Hochschulreife")                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Allgemeinbildende Schule       | Shkollat e arsimit të përgjithshëm janë të gjitha llojet e shkollave që nuk përfundojnë me kualifikim profesional.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Arbeitsgemeinschaften (AG)     | Shumë shkolla ofrojnë grupe pune (AG) me tema të ndryshme ku nxënësit mund të marrin pjesë (p.sh. kor, kitare, punime druri). Pjesëmarrja është në përgjithësi vullnetare dhe ndodh jashtë orarit të zakonshëm mësimor. AG-të mund të drejtohen për shembull nga mësuesit, prindërit ose nxënësit e mëparshëm.                                                                                                                                     |
| AVdual                         | "Dualja e përgatitjes profesionale" (AVdual) u drejtohet të rinjve që ende kanë nevojë për mbështetje për fillimin e tyre profesional pas frekuentimit të një shkolle të përgjithshme. Përgatitja njëvjeçare e trajnimit profesional ka një qasje të dyfishtë; d.m.th. zhvillohet si në shkollë ashtu edhe në një kompani të caktuar.                                                                                                              |
| Begleitende Lernhilfe          | Fëmijët që ndjekin mësimin në një klasë të rregullt, por nuk janë ende të sigurt për gjermanishten, mund të marrin mbështetje përveç orëve të rregullta mësimore. Nën shoqërimin e mësuesve, fëmijët mund të bëjnë detyrat e shtëpisë dhe të praktikojnë gjermanishten.                                                                                                                                                                            |
| Beratungslehrkraft             | Mësuesit këshillues janë mësues të trajnuar nga psikologët e shkollës për të këshilluar nxënësit dhe prindërit e tyre. Ata janë personat që duhet të kontaktoni nëse keni vështirësi në shkollë ose nëse keni pyetje në lidhje me sistemin arsimor.                                                                                                                                                                                                |
| Berufliche Orientierung (BO)   | Orientimi profesional (ose: orientimi drejt profesionit) në Baden-Württemberg fillon që në klasën e 5-të. Kjo ka për qëllim t'i ndihmojë nxënësit të merren me zgjedhjen e tyre të karrierës në një fazë të hershme dhe të mund të marrin më vonë një vendim të informuar.                                                                                                                                                                         |
| Bezugserzieher                 | Është e rëndësishme që fëmijët të kenë një person reference të përhershme, veçanërisht në vitin e parë të jetës së tyre. Prandaj, disa Kita (çerdhe) përdorin "sistemin e edukimit e edukatorëve referues". Kjo do të thotë se për fëmijët kujdeset i njëjti person në fillim. Pas një farë kohe do të përfshihen edhe edukatorë të tjerë. Edukatori ose edukatorja referuese përkatëse është njëkohësisht edhe personi i kontaktit për prindërit. |
| Bildungspaket                  | Paketa arsimore përkrah fëmijët dhe të rinjtë, prindërit e të cilëve kanë më pak të ardhura. Kjo paketë përmban shërbime për arsimim dhe pjesëmarrje, pra oferta në shkollë dhe në kohën e lirë, p.sh. në udhëtimet me shkollën, mësimet private, pushime. Prindërit mund ta përdorin këtë paketë kur nuk kanë mundësi t'i përballojnë vetë kostot për oferta të tilla.                                                                            |
| Bildungsplan / Lehrplan        | Plani i formimit – më parë: Kurrikula – përfshin përmbajtje dhe objektiva mësimore në varësi të llojit dhe nivelit shkollor. Planet janë publikisht të aksesueshme dhe të detyrueshme për mësuesit.                                                                                                                                                                                                                                                |
| Einschulungsuntersuchung (ESU) | Para se të vijnë fëmijët në shkollë, lënë një takim me Gesundheitsamt (Sektori Shëndetësor). Profesionistët mjekësorë kontrollojnë nëse fëmijët janë gati për të ndjekur shkollën nga pikëpamja zhvillimore dhe shëndetësore. Ky quhet ekzaminim për regjistrim në shkollë, shkurtimisht ESU.                                                                                                                                                      |
| Elternbeirat                   | Këshilli i Prindërve përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga prindërit nga të gjitha klasat e një shkolle. Ky këshill përfshihet në të gjitha çështjet e rëndësishme që lidhen me shkollën. Këshilli i Prindërve i një shkolle zgjedh kryetarin e këshillit dhe zëvendësin e tij.                                                                                                                                                                 |

|                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Elterngespräch               | Shkëmbimi i rregullt midis prindërve dhe mësuesve është i rëndësishëm për t'i mundësuar fëmijës një përkrahje të përshtatshme. Për këtë arsye mbahen mbledhje të rregullta me prindërit. Mbledhjen mund ta kërkojnë si prindërit ashtu edhe mësuesit. Në përgjithësi zhvillohet në shkollë, por nëse doni, mund të shoqërohet nga një përkthyes. Kjo vlen edhe për Kita-n.                                                                           |
| Elternsprechtag              | Diskutimet prindër-mësues zhvillohen rregullisht në shumë shkolla dhe janë një mundësi e mirë për prindërit që të shkëmbejnë ide me mësuesit e fëmijëve të tyre. Mësuesi ose mësuesja e klasës apo administrata e shkollës ju ftojnë në këto diskutime. Prindërit mund të tregojnë paraprakisht se me cilin mësues dëshirojnë të flasin. Diskutimet prindër-mësues nuk janë të detyrueshme, por janë të rëndësishme për shkëmbimin e informacioneve. |
| Elternvertretung             | Për të përfshirë prindërit në jetën shkollë dhe për t'u mundësuar atyre të thonë fjalën e tyre, janë caktuar dy prindër përfaqësues në çdo klasë. Këta persona quhen Elternvertretung (përfaqësues të prindërve). Ata i përfaqësojnë prindërit e klasës në Këshillin e Prindërve dhe në takimet me mësuesit, si dhe i informojnë prindërit për gjëra të rëndësishme. Të gjithë prindërit e klasës mund t'u drejtohen përfaqësuesve.                  |
| Erziehungspartnerschaft      | Partneriteti arsimor ka të bëjë me bashkëpunimin midis prindërve dhe profesionistëve në fushën e arsimit (p.sh. mësues, edukatorë). Meqenëse të dy janë përgjegjës për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, duhet të shkëmbejnë ide dhe të diskutojnë për vështirësitë që hasin.                                                                                                                                                                       |
| Ferienbetreuung              | Në pushimet shkollë shkolla është e mbyllur, kështu që nuk ka mësim. Megjithatë, shumë shkolla, shoqata ose qytete ofrojnë kujdes për fëmijët. Kjo nuk është e detyrueshme dhe shpesh kushton. Nëse prindërit nuk mund ta përballojnë tarifën e rregullt, zakonisht ofrohet një tarifë më e ulët.                                                                                                                                                    |
| Ganztagschule                | Në Baden-Württemberg shkollat po bëhen gjithnjë e më shumë "shkolla ditore" (Ganztagschulen). Në shkollat ditore fëmijët dhe adoleshentët kanë mundësi që jo vetëm të marrin mësim, por edhe të marrin së paku 7 orë në ditë kujdes. Ekzistojnë shkollat ditore të detyrueshme ku të gjithë fëmijët marrin të njëjtën kohë përkushtuar kujdesit. Ka edhe formularë zgjedhjeje ku prindërit mund të zgjedhin nga 3 deri në 4 ditë.                    |
| Gesamtelternbeirat (GEB)     | Këshilli i Përgjithshëm i Prindërve është një organ i përbërë nga kryetarët e këshillave të prindërve të të gjitha shkollave publike me të njëjtin bord shkolle (në përgjithësi një qytet ose bashki). Ky këshill përfaqëson interesat e prindërve kundrejt autoriteteve arsimore.                                                                                                                                                                   |
| Grundschulempfehlung         | Rekomandimi që bën shkolla fillore është një vlerësim për të treguar se cila shkollë e mesme përshtatet më shumë për fëmijën. Ajo përgatitet nga mësuesit e fëmijës dhe u dërgohet me shkrim prindërve. Rekomandimi nuk është detyrues, por duhet të merret seriozisht nga prindërit.                                                                                                                                                                |
| Grundschulförderklasse       | Në përgjithësi fëmijët hyjnë 6 vjeç në shkollë. Por ndonjëherë ndodh që fëmijëve t'u shtyhet shkolla me një vit; d.m.th. ta fillojnë atë në moshën 7 vjeçare. Para kësaj ata mund të frekuentojnë një klasë ndihmëse në shkollën fillore ku mund të mësohen me shkollën në mënyrë lozonjare dhe të nxiten sërish vetë për të shkuar.                                                                                                                 |
| Hochschulreife               | Kualifikimi i hyrjes në universitet vërteton se një nxënës ka aftësinë për të studiuar. Dallimi bëhet midis kualifikimit të përgjithshëm të hyrjes në shkollën e lartë (Abitur), i cili është i vlefshëm për të gjitha universitetet, dhe kualifikimit të hyrjes në arsimin e lartë për një drejtim të veçantë (Fachabitur), i cili është i vlefshëm për universitetet e shkencave të aplikuara.                                                     |
| Hochschulzugangsberechtigung | Nëse doni të studioni në një universitet gjerman, ju nevojitet një i ashtuquajtur "kualifikim i hyrjes në universitet". Ky është një kualifikim arsimor që ju kualifikon për studime universitare. Kualifikimi mund të sigurohet përmes                                                                                                                                                                                                              |

|                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                     | arritjeve akademike ose arritjeve profesionale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Hort                                                | Nxënësit deri në moshën 14 vjeç marrin kujdes pas shkollë në një qendër përkujdesjeje. Qendra e përkujdesjes pas shkollës nga e hëna në të premte ofron kujdes fakultativ pasditeve dhe në përgjithësi është e hapur edhe gjatë pushimeve shkollore. Qendra mund të jetë në shkollë ose afër saj.                                                           |
| Inklusion                                           | Fëmijët që kanë të drejtë për mbështetje të veçantë arsimore mund të ndjekin një shkollë SBBZ (shikoni SBBZ) ose një shkollë të përgjithshme. Në shkollën e përgjithshme do të mësojnë me të gjithë nxënësit e tjerë të shkollës; kjo quhet gjithëpërfshirje. Në përgjithësi, ata marrin mbështetje shtesë përveç mësimit ose gjatë mësimit.                |
| Inklusionskraft                                     | Punonjësi që merret me gjithëpërfshirjen quhet specialist ose punonjës integrimi. Ai i përkrah fëmijët dhe të rinjtë që kanë të drejtë për mbështetje të veçantë arsimore për të marrë certifikatën e tyre të përfundimit të shkollës.                                                                                                                      |
| Jahrgangsübergreifende / Jahrgangsgemischte Klassen | Disa shkolla fillore i mësojnë fëmijët e klasave 1 dhe 2 dhe fëmijët e klasave 3 dhe 4 bashkë. Avantazhi i kësaj është që të rinjtë mësojnë nga më të mëdhenjtë. Në këtë mënyrë të mëdhenjtë mësojnë si të marrin përgjegjësi.                                                                                                                              |
| Kernzeitbetreuung                                   | Kujdesi para dhe pas mësimit (shikoni Shkolla Fillore e Qëndrueshme)                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Kita                                                | Qendrat e përkujdesit ditor (Kitat) ndahen në çerdhe për fëmijët nën 3 vjeç dhe kopsht për fëmijët 3-6 vjeç. Në Kita fëmijët janë nën kujdesin e edukatorëve dhe përgatiten për shkollë.                                                                                                                                                                    |
| Klassenfahrt                                        | Udhëtimi me klasën është një ekskursion me të gjithë klasën që zhvillohet gjatë orarit të shkollës. Zakonisht udhëtimi me klasën zgjat disa ditë, që do të thotë se klasa qëndron gjatë natës në një bujtinë ose një kamp shkollor (shikoni kampin shkollor). Zakonisht eskursioneve një-ditore me klasën konsiderohen si eskursione shkollore.             |
| Klassenlehrertandem                                 | Tandem (çift) mësuesish do të thotë që dy mësues drejtojnë bashkërisht një klasë. Kështu nxënësit kanë dy persona kontakti.                                                                                                                                                                                                                                 |
| Klassenpflegschaftssitzung                          | Shoqata e të gjithë prindërve dhe mësuesve në një klasë quhet kujdestaria e klasës. Për çdo semestër shkollor bëhet të paktën një mbledhje e kujdestarëve të klasës dhe ky është takimi i kujdestarisë së klasës. Kjo quhet gjithashtu edhe mbledhja e prindërve. Përveç prindërve, është i pranishëm mësuesi i klasës dhe shpeshherë edhe mësues të tjerë. |
| Kursstufe                                           | Termi "Niveli i kursit" përdoret në gjimnaz. Ai përshkruan dy vitet e shkollës para diplomimit nga shkolla e mesme. Këto dy vite ndahen më tej në katër nivele kursi.                                                                                                                                                                                       |
| Landeselternbeirat (LEB)                            | Këshilli i Prindërve të Landit të Baden-Württemberg zgjidhet nga kryetarët e këshillave të prindërve të shkollave të landit. Këshilli i Prindërve të Landit këshillon Ministrinë e Arsimit dhe përfaqëson interesat e prindërve në nivel landi.                                                                                                             |
| Landeschülerbeirat (LSBR)                           | Këshilli i Nxënësve të Landit është një organ i përbërë nga nxënës të llojeve të ndryshme shkollash. Ai e këshillon Ministrinë e Arsimit mbi pyetjet në lidhje me organizimin e mësimit dhe shkollave.                                                                                                                                                      |
| Lernstandgespräch                                   | Diskutimi i statusit të të mësuarit (i quajtur edhe diskutimi i zhvillimit të të mësuarit) është një diskutim midis mësuesit dhe nxënësve shkollorë, ku flitet për përparimin e tyre lidhur me të mësuarit. Në këto diskutime janë të pranishëm edhe prindërit.                                                                                             |
| Masernschutzgesetz                                  | Në Kitat dhe shkollat në Baden-Württemberg është i detyrueshëm vaksinimi kundër fruthit. Kjo do të thotë: Çdo fëmijë duhet të marrë vaksinimin kundër fruthit para ditës së parë të Kitas ose shkollës. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që fëmija të mbrojë veten dhe të tjerët në grup ose klasë nga kjo sëmundje.                                       |

|                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nachmittagsbetreuung    | Shumë shkolla të përgjithshme ofrojnë kujdes fleksibël pasditeve. Aty fëmijët dhe të rinjtë mund të marrin kujdes pas mësimit, p.sh. për sa kohë që prindërit janë në punë. Kujdesi fleksibël pasditeve fillon nga ora 12:00 dhe mbaron në orën 17:30.                                                                                                                                                                                                                 |
| Orientierungsplan       | Plani i orientimit është baza për punën pedagogjike në Kita. Dokumenti, i cili është në dispozicion të publikut, u jep edukatorëve shtysë për arsimimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të fëmijëve.                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Orientierungsstufe      | Nivelet 5 dhe 6 të klasës përshkruhen si nivele të orientimit. Pas kalimit nga shkolla fillore fëmijët orientohen për në shkollat e mëtejshme. Nëse shohin se lloji i shkollës që kanë zgjedhur është shumë i vështirë ose shumë i lehtë për ta, mënyra më e lehtë për të kaluar në një lloj tjetër shkolle janë klasat 5 dhe 6.                                                                                                                                       |
| Regelklasse             | Klasa e zakonshme është klasa që ndjekin shumica e nxënësve. Normalisht ajo është lloji i klasës që konsiderohet i respektuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| SBBZ                    | Qendra e Edukimit të Veçantë dhe Këshillimit, shkurtimisht BBZ, është një lloj shkolle ku fëmijët mësohen me nevoja të veçanta. Ka SBBZ me përparësi të veçanta financimi.                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Schulamt                | Autoriteti i shkollës është një institucion shtetëror përgjegjës për kontrollin teknik të shkollave dhe organizimin e mësuesve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Schulbegleiter          | Shoqëruesit e nxënësve kujdesen për ata që kanë nevojë për mbështetje në fusha shumë të ndryshme. Ata i ndihmojnë nxënësit të hyjnë në klasë ose shërbejnë si pikë kontakti në rast krizash personale. Në vend të termit "shoqërues nxënësish" përdoret edhe termi "personat e gjithëpërfshirjes".                                                                                                                                                                     |
| Schülermitverantwortung | Një shkollë e mirë mbështetet te nxënësit që duan të ndihmojnë në organizimin dhe ndarjen e përgjegjësisë në jetën shkollore. Për këtë nxënësit e një klase zgjedhin dy kujdestarë klase duke filluar nga klasa e 5-të. Kujdestarët e klasës janë anëtarë në këshillin e nxënësve të shkollës. Ata mund të marrin pjesë në organe të tjera siç është konferenca e shkollës. Edhe nxënësit nga klasa e 7-të mund të marrin pjesë në Bordin e Nxënësve të Landit (LSBR). |
| Schulförderverein       | Shoqata mbështetëse e shkollës është një shoqatë jofitimprurëse, qëllimi i së cilës është të mbështesë një shkollë ose institucion arsimor. Aty përfshihen në veçanti prindërit dhe mësuesit.                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Schulkonferenz          | Ka organe të ndryshme në shkollë që ndihmojnë në përcaktimin e jetës së përditshme dhe përparësive të një shkolle. Konferenca e shkollës është organi më i lartë i pjesëmarrjes. Aty përfaqësohen së bashku mësuesit, prindërit dhe në shkollat më të larta edhe nxënësit.                                                                                                                                                                                             |
| Schullandheim           | Kampet shkollore janë vende mësimi jashtë shkollës. Zakonisht ato gjenden në një mjedis ku ka shumë natyrë. Klasat e shkollës i kalojnë javët e tyre të projektit në kampet shkollore dhe mësojnë shumë gjëra të reja rreth natyrës, peizazhit dhe kulturës.                                                                                                                                                                                                           |
| Schulpflicht            | Në Baden-Württemberg shkollimi është i detyrueshëm. Kjo do të thotë se fëmijët nga 6 vjeç e lart duhet të ndjekin shkollën. Ata janë të detyruar të paraqiten në shkollë. Nëse fëmija është p.sh. i sëmurë, prindërit duhet të dërgojnë një justifikim me shkrim. Detyrimi për shkollë mbaron kur fëmija mbush 18 vjeç.                                                                                                                                                |
| Schulpraktikum          | Praktika shkollore (ose praktika e nxënësve, praktika profesionale) është një masë për orientimin drejt profesionit (shikoni orientimin profesional) Të gjithë nxënësit që ndjekin klasën e 9-të të Realschule (Shkollë e mesme) ose gjimnazit, duhet të bëjnë një praktikë një-javore. Në Realschule kjo quhet BORS, në gjimnaz BOGY.                                                                                                                                 |
| Schulsozialarbeit       | Puna sociale e shkollës zhvillohet bashkërisht nga Jugendhilfe (Shërbimi i Mirëqenies së Rinisë) dhe shkolla. Ky është një shërbim që u ofrohet të gjithë nxënësve të një shkolle. Në veçanti është për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët                                                                                                                                                                                                                                |

|                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|--------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                    | kërkojnë mbështetje profesionale në rast problemesh dhe konfliktesh. Prindërit mund t'i drejtohen edhe punonjësit social të shkollës, nëse kanë probleme me shkollën ose fëmijën e tyre.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Sonderpädagogischer Förderbedarf /<br>Sonderpädagogische Förderung | Nëse një fëmijë ka nevojë për përkrahje të veçantë, mund t'i jepet një mbështetje e veçantë pedagogjike. Kjo përcaktohet nga specialistët dhe është një parakusht për të ndjekur SBBZ-në (shikoni SBBZ-në) ose një mbështetje gjithëpërfshirëse në një shkollë të përgjithshme (shikoni gjithëpërfshirjen).                                                                                                                                                                                                                             |
| Übertrittsverfahren                                                | Kalimi nga shkolla fillore (deri në klasën e 4-të) në shkollë të mesme (nga klasa e 5-të) quhet transferim. Për ta bërë kalimin sa më të lehtë për fëmijët dhe prindërit ekzistojnë procedura të caktuara. Këto përfshijnë, për shembull, një ngjarje informative ku prezantohen llojet e shkollave të mesme, rekomandimet e shkollës fillore, bisedat me prindër dhe mundësinë që prindërit të kërkojnë këshilla.                                                                                                                      |
| VAB-O                                                              | Në "vitin e parakualifikimit për punë/profesion" (VAB-O), fokusi është në transmetimin e aftësive të gjuhës gjermane. Ai është i përshtatshëm për të rinjtë me pak ose aspak njohuri të gjermanishtes që duan të nisin trajnimin profesional. VAB-O zhvillohet në një shkollë profesionale dhe në të njëjtën kohë ofron një pasqyrë të jetës profesionale.                                                                                                                                                                              |
| Verlässliche Grundschule                                           | "Shkolla fillore e qëndrueshme" është një shërbim i kujdesit për fëmijët në shkolla. Në varësi të orës së mësimin, kujdesi ofrohet para dhe pas mësimin. Kjo garanton që fëmijët të marrin kujdes deri në gjashtë orë në mëngjes (p.sh. nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 13:00 pasdite). Koha e kujdesit përfundon në orën 14:00.                                                                                                                                                                                                     |
| Vorbereitungsklasse (VKL)                                          | Klasën përgatitore e ndjekin fëmijët që flasin pak ose aspak gjermanisht. Ata marrin mbështetje intensive gjuhësore dhe janë gati për mësim të rregullt në klasë. Ata marrin gjithashtu njohuri bazë për demokracinë në Gjermani.                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Vorschulunterricht                                                 | Përpara se fëmijët të fillojnë shkollën, shumë Kita ofrojnë mësim parashkollor. Fëmijët e ndjekin këtë në vitin e fundit të Kitas. Ata përgatiten për shkollën fillore duke ushtruar qëndrimin pa lëvizur, duke bërë ushtrimet në shkrim dhe aritmetikë ose duke mësuar rregullat e shkollës.                                                                                                                                                                                                                                           |
| Wahlfach                                                           | Në përgjithësi të gjitha lëndët që mësohen në shkollë janë të detyrueshme për nxënësit. Si rrjedhojë, ata duhet të marrin pjesë në to. Shumica e temave janë të specifikuar nga ministria. Ka edhe të ashtuquajtura lëndë me zgjedhje. Fëmijët mund të vendosin vetë se cilën lëndë duan të mësojnë. Shpesh ndodh kështu me gjuhët, për shembull. Në gjimnaz nxënësi mund të vendosë nëse do të mësojë frëngjisht apo latinisht nga klasa e 7-të. Pasi të jetë bërë zgjedhja, frekuentimi i kësaj lënde është gjithashtu i detyrueshëm. |
| Weiterführende Schule                                              | Fëmijët i kalojnë katër vitet e para shkollorë në fillore. Pastaj, zakonisht ndërrojnë shkollën. Shkollat që zhvillojnë mësim nga klasa e 5-të quhen "shkolla të mesme".                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Zweiter Bildungsweg                                                | Sistemi arsimor në Baden-Württemberg është i penetrueshëm. Kjo do të thotë se gjithmonë ekziston mundësia për të vazhduar shkollimin dhe për të ndërruar shkollën. Edhe personat që kanë mbaruar formimin profesional mund të kthehen në shkollë dhe të fitojnë kualifikime të reja shkollorë. Ky quhet arsimimi i shansit të dytë. Shpesh këto kualifikime fitohen në kolegjet profesionale.                                                                                                                                           |